# KËRKESË PËR INFORMIM

**PER:** PD, PARTIA DEMOKRATIKE
**NGA:** INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE / OPEN DATA ALBANIA
**LËNDA:** KËRKESË PËR INFORMIM PËR FINACIME TË PËRFITUARA ZGJEDHJET VENDORE 2015
**DATE:** 2015-06-09
**CC:** Z. ARBEN RISTANI – SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
**CC:** Z. ARBEN IBRO – KRYEFINANCIER I PARTISE

I nderuar zoti Ristani,
I nderuar zoti Ibro,

Me anë të kësaj shkrese, në emër të Institutit Shqiptar të Shkencave dhe në kuadër të programeve tona për transparencë dhe të dhëna të hapura (open data) paraqesim kërkesën për të na mundësuar me shkrim informacion në lidhje me financimin e fushatës për zgjedhjet vendore, prej datës 22 maj 2015 për subjektin tuaj zgjedhor.

Më konkretisht lutemi të na informoni në lidhje me:

a) listën e dhuruesve të fondeve jopublike që keni përfituar prej datës 21 maj 2015 dhe që janë mbi shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose shërbime apo sende të barasvlershme me të;
b) listën e çdo shpenzimi që keni kryer eventualisht prej datës 21 maj 2015 me fondet vjetore të përfituara nga buxhetit i shtetit 2015.

Kërkesa jonë bazohet në nenin 9, paragrafi i tretë i Kushtetutës, neni 87/1, neni 89 dhe neni 90 të Kodit Zgjedhor, si dhe të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" neni 2 shkronja "c", neni 3 dhe neni 11.

Partitë politike kanë një rol të veçantë në shoqërinë demokratike dhe transparenca në kohë e financimeve të tyre, veçanërisht në fushata zgjedhore, është element me rëndësi themelore. Partitë politike kryejnë detyra publike, kanë një rol unik në një shoqëri demokratike dhe mbartin të drejta dhe detyrime si subjekte të së drejtës publike.

Nga ana tjetër kjo krijon njëherësh mundësinë që të zbatohen në praktikë ato që përbëjnë sjellje transparente dhe demokratike në shoqëri dhe do të sjellin një vlerë të shtuar të këtij procesi zgjedhor.

Më lejoni të kujtoj gjithashtu se në mbështetje të nenit 15, paragrafi i parë i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" lutem na përcillini përgjigjen tuaj brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së kësaj kërkesë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**Me respekt**

**Aranita BRAHAJ**

**Drejtore Ekzekutive**

**Instituti Shqiptar i Shkencave**
Rr. Asim Vokshi, Pallati 13/25 kat 3 TIRANË
Email: aranita.brahaj@ais.al
Tel: 0682001718

RR 184 408 341 AA

POS

Zyra Postare

LAJMËRIM MARRJ

Shqipëria

SHQIPËRIA 10 LEKË

TIRANA 08 JUN 2015 1001

Ky lajmerim - marrje do te kthehet ne adresën time si më poshtë:

Z. Pranvera Brahaj
Instituti Shqiptar i Shkencave
Dr. Asim Vokshi
Pallati 13/25, kati 3
Tiranë

Plotësohet nga dërguesi i cili duhet të tregojë drejtimin e tij të plotë për kthimin e këtij lajmërimi

Mod P6

**1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT**

Objekti............ Nr.......... datë.......... Lek..........

Është pranuar në zyrën Partia Demokratike ......në drejtim të zotit
Arben Ristani - Sekretar i Përgjithshëm
Blv. "Zhan Dark" nr. 11
Tiranë

**2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT**

Dorëzuar 10/6/15
më datën..........

Objekti i sipërtreguar është..........

Paguar

Emri mbiemri i marrësit të objektit

Emri mbiemri i shpërndarësit

SHËNIME TË VEÇANTA

Arben Bulgiza

Vula datare e Zyrës Dorëzuese të objektit

TIRANË 10 JUN 2015